



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
**Nr.01-060/01-12830/24 datë:22.05.2024**



**Npi – 01/181 datë: 29.05.2024**

Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes shqyrtoi rekomanimin e MAPL-së Nr.0-185-1 të datës 13.05.2024 për Rishqyrtimin e Rregullos Komunale për Transparenc me numër Npi-01-78 të datës 26.02.2024, si dhe duke marrë parasysh Rekomandimin e KPF-së, Npi – 01/171 të datës:27.05.2024, në seancën e mbajtur më 29.05.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT ME NUMËR  
Npi-01/78 TË DATËS 26.02.2024**

**I**

Kuvendi Komunës së Shtimes, në Seancën e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 29.05.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit për miratimin e Rregullorës Komunale për Transparencë Npi-01/78 të datës 26.02.2024, si dhe në Rregulloren Komunale për Transparencë Npi-01/79 të datës 26.02.2024 si vijon:

- Baza ligjore bëhet si vijon: "Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".
- Neni 27.4 bëhet si vijon: "Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje".

**II**

**A r s y e t i m:**

- Në Vendimin e mëparshëm të Kuvendit me numër Npi-01/78 të miratuar më 26.02.2024 baza ligjore ka qenë si vijon: "Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Si dhe duke u bazuar në nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".

- Ndërsa te Neni 27.4 i Rregullores Komunale për Transparencë Npi-01/79 të datës 26.02.2024, teksti ka qenë si vijon: “Nëse organet komunal nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit”.
- Pas Rekomandimit të MAPL-së Nr.0-185-1 të datës 13.05.2024 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Transparencë, Kuvendi i Komunës së Shtimes mori vendim sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

### III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi